Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 19
Datë: 05.02.2014

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve bazuar në nenin 4 me pikat 1,3,6,9 dhe nenit 5 të pikave 1,2,3 të Rregullores së punës për Këshillin Drejtues të AKK-së, si dhe në mbështetje të nenit 14, 15, 16, 17 të kësaj rregullore, si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (nr. 03- L 0600), neni 10, neni 21.3 neni 22, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2011, miratuar nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritet Kombëtar i Kualifikimeve nxjerr:

VENDIM

1. Aprovohet lista dy vjeçare e eksperteve të jashtëm për procesin e validimit të kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve të arsimit dhe aftësimit profesional nga sektori i Shkencave Sociale për profilin Puna dhe të rinjtë në Komunitet.

2. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i obliguar që varësisht nga nevojat dhe kërkesat të përzgjedhë këta ekspertë nga kjo listë dy vjeçare.

3. Në rastet kur kemi institucione aplikuese të cilat kërkojnë akreditim dhe validim të kualifikimeve të nivelit 5 të KKK, AKK duhet të angazhojë tre ekspertë të jashtëm të fushës përkatëse.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi të gjitha palëve të interesit.

Kryetari i KD së
AKK-së
Ragip Gjoshi